



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:127343
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05734288

C.nr.683/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Pejës", Magj. Prishtinë- Fushë Kosovë, pa nr. të cilin e përfaqëson Mimoza Kllokoqi, zyrtare ligjore, sipas autorizimit, kundër të paditurit Xh.D. nga fshati N. Komuna Pejë, baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance me datën 24.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE, me numër të lëndës Nd.nr.399/24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë, me datën 24.04.2024, e lidhur në mes Byrosë Kosovare të Sigurimit me seli në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Pejës", Magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, pa nr., dhe të paditurit Xh.D. nga fshati N. Komuna Pejë, baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësja, nëpërmjet të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 14.06.2019 kundër të paditurit Xh.D. nga fshati N. Komuna Pejë, baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material.

Në qendrën e ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë 24.04.2024.

Qendra për Ndërmjetësim, e ka njoftuar gjykatën se me datë 24.04.2024, palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre. Ndërsa me datën 03.05.2024, e njëjta është korrigjuar për shkak të lëshimit teknik.

Gjykata, duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 426 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 15 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me datën 28.07.2018, pas shqyrtimit të marrëveshjes me datën

24.05.2024, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbartimor, pra paraqet titullit përmbartues.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.683/19, me datë 24.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.